

**GAZMEND LEKA / S'KA MË TEMPULLARË,  
TË GJITHË E DIMË TË VËRTETËN!  
GAZETA STANDART / 09/01/2010**

Gazmend Leka, piktori pranon heshtjen vetëm për një sakrificë të qëllimshme; të udhëtojë drejt qendrës, qenies që është vetja. Këtu prej kohësh gjen gjuhën e pikturës së tij, shenjën dhe simbolet dhe pa hezitim flet për një kalim superticioz të shoqërisë, ashtu siç e interpreton ai:

...se iku momenti më i keq i njerëzimit, çfarë ka përjetuar në këto 2 mijë vjet, ai më i rëndi - errësira. Leka që ka zgjedhur një triptik, “ Udhëtimi i qenies ”, për të konkuruar në ekspozitën “ Onufri ”, tregon se shenjat e tij flasin për një filozofi të lartë - se është koha e ndriçimit të njeriut, që të vërtetat nuk janë më vetëm për tempullarët, e murgjit dhe nuk ka më dishepuj e mjeshtër që ndiqen. Të gjithë njerëzit tani ndërtojnë vizione, vetë njeriu është mjeshtër, dishepull, ku edhe shkenca po e largon misticizmin nga përrallat, legjendat, gënjeshttrat - të gjithë tani e zotërojmë të vërtetën. Kjo ekspozitë vetëm për artistët shqiptarë e ka rikthyer piktorin në idenë e parë, se duhet të jetë një veprimtari kombëtare për të njohur hartën e artit viziv në Shqipëri, pa përdorur emra të artistëve të huaj.

Ndërsa e sheh si delikate marrëdhënien e ftohtë që është ndër artistë, si komunikim e njohje të njëri-tjetrit, duke e shpjeguar si letargji të shoqërisë shqiptare. Ndërsa nuk është çudi ta shohim edhe në ekspozitën e anatemuar si vazhdimësi e traditës, atë të “ Nëntorit ” - thjesht është duke pritur ftesën nga organizatorët me dëshirën e krijuesit për të qenë i ekspozuar, si arsye pse është nxitur të jetë edhe tek “ Onufri ”.

**Ju jeni një nga konkurrentët e “ Onufrit ”. Mund të na thoni çfarë ju shtyu të merrnit pjesë në këtë ekspozitë? Pas sa kohësh riktheheni në Galerinë e Arteve?**

Në ekspozitën “ ONUFRI ” kam marrë pjesë herë pas here, kam lënë ekspozita bosh, vakume dhe pastaj jam rikthyer. Dhe këtë herë mora pjesë, sepse kisha një koleksion shumë të madh punësh të bëra kohët e fundit. Mbasi u mbylla në studio, munda të krijoja një seri prej 30 punësh. Në pamundësi për të bërë një ekspozitë personale të shpejtë, doja të testoja një copës mozaiku nga punët e fundit. Kjo ishte arsyeja e thjeshtë, pjesa tjetër ishte nxitja që më dha kuratori Parid Teferiçi, i cili më erdhi në studio. Ai kishte marrë një udhëtim në të gjitha studiot e artistëve për të parë dhe testuar se çfarë bëhet në studiot e tyre. Ishte një dëshirë nga kuratori që këto punë të ekspozoheshin. Pasi pa të gjithë koleksionin, të dy kishim të njëjtin mendim për t’u paraqitur me triptikun. Ndërsa arsyeja tek unë ishte shumë e thjeshtë pra; dëshira e krijuesit për të ekspozuar.

**Ky triptik, i quajtur “ Udhëtim i qenies ” del jashtë kornizës ikonike për të cilën ju njiheni në stilin tuaj. Pse ky prezantim, çfarë është ky udhëtim i brendshëm i një piktori ndërsa m’u shprehët se “ jam akoma në burgun tim ” ?**

Nuk mendoj se është një shmangie nga ajo çfarë përbën thelbin tim, Pothuaj e gjithë krijimtaria ime është e mbushur me këto lloj titujsh, nuk është se kam krijuar ndonjë alibi të re për atë çfarë unë krijoj. Unë fillimisht doja të bëja një cikël të madh prej nëntë pikturash për të bërë një ekspozitë personale. Por, siç të kap nganjëherë ethet e lindjes për gjëra të tjera, m’u duk me e mira që ta ndërprisja dhe mbërrita në këtë treshe, e cila mund të shihet dhe e veçantë, por mund të jenë edhe në një lidhje të brendshme. Megjithëse i kam vënë titullin “ Udhëtimi i qenies ”, unë shpesh herë para së të arrij në tituj përfundimtar i ndërroj, ka shumë shtresa në momentin kur pikturoj, dhe kjo ka të bëjë me shenjat dhe simbolet lojën e tyre. Dhe kjo njihet. Për shembull dragonjtë e

pikturës së parë i kam parë në katedralet, ose dorën e cila mban simbolet në gjithë gishtat e saj, mund ta shohësh në traktatet e alkimisë, ose në momentin e fundit ai ekzorcizmi i së keqes dhe hapja e syve mund ta gësh pikërisht në gravurat e vjetra mesjetare. Por, momenti i implementimit që kam bërë këtu, mendoj se ka marrë një shenjë personale, që ka vulën time. Megjithatë mendoj se përdorimin e këtyre shenjave dhe titullin, nuk e përdor për kurth që ta bëj sa më interesante, sa më tërheqëse për të thithur vështrimin e tjetrit. Mua më intereson në fund të fundit që ajo të jetë pikturë, që të shkaktojë një emocion dhe më pas secili nga autorët mendoj se ka problematikën e vet. Triptiku është një problematikë krejtësisht personale. Është një udhëtim brenda vetes time, që fillon me një eklips, dhe diellin e kam konsideruar syrin e madh të qiellit. Cikli mbaron me sy të hapura, duke perceptuar hyrjen e shoqërisë në periudhën e ujorit, që lë pas periudhën e peshkut. Një periudhë që pak njerëz e dinin diturinë dhe shumë veta nuk e dinin, qoftë duke përshkruar edhe mesjetën. Sot ka ardhur një moment që e gjithë shoqëria duke kaluar nga periudha e peshkut, që është tek tabloja e dytë, ku dora është shenja e filozofisë së lartë, kalon në momentin e fundit tek hapja e syve - domethënë e vërteta e cila ishte e mbyllur tani hapet në shumë njerëz. Nuk është tani pra pasuri e disa njerëzve. Por në fund të fundit për mua ajo është pikturë dhe po të mos ishte pikturë këto pak rëndësi do të kishin më pas.

**Po flisni për një raport mistik mes shoqërisë dhe shkencës; për domethënien e të vërtetës sot që mbaron triptikun tuaj me “ hapjen e syve ” - cili është realiteti i shenjave sot, si e interpretoni këtë moment të shoqërisë, çfarë po arrin njeriu?**

Mua më ka interesuar shumë jo vetëm pjesa e pikturës, artit, jam i apasionuar shumë pas muzikës, teatrit, kinemasë dhe jam spektator i rregullt i tyre. Por, jam dhe tek ajo pjesë që duket sikur një artisti nuk i intereson shumë, siç është matematika, astrologjia, fizika qoftë edhe gjithë bota mistike, bota e shenjave,

simboleve. Tërë jetën time e kam ndjekur me vëmendje sepse e kam parë si gjë të vërtetë, pavarësisht që është nën të, në themele, e padukshme por frytet e saj i kam ndjerë, dhe me ato gjëra shpirti im është ushqyer. Unë jetoj në atë lloj realiteti. Ajo çfarë më ka bërë më shumë përshtypje dhe refleksi i saj pasqyrohet te ky triptik që unë kam, është momenti i kalimit të shoqërisë njerëzore nga periudha e cila quhet periudha e shenjës së peshkut, ku ishte një periudhë e rëndë, të cilën indianët e quanin periudha Kaliuga, ku e vërteta ishte pasuri e vetëm disa njerëzve. Ashtu siç ndodhte në mesjetë që ishte pasuri vetëm e murgjve ose e tempullarëve ose e disa personazheve, ndërsa pjesa tjetër rrinte në një errësirë të plotë. Sot ka ndryshuar shoqëria njerëzore, po kalon nga shenja e peshkut po hyn shenjën e ujorit. Kjo shenjë nuk është më ajo shenja e rrezikshme, hermetike, që ka pasur shenja e peshkut - por është një shenjë ku shoqëria njerëzore hyn në një fazë ku e vërteta nuk është më për disa njerëz, por është gati për të gjithë shoqërinë. Nëse në periudhën e peshkut ka qenë një ose dy njerëz që kanë pasur vizione, sot ka shumë njerëz me vizione. Çfarë është më e çuditshmja, po ndodh një fenomen shumë i bukur, përfundimisht, që shkenca feja, arti, filozofia po fillojnë të bashkohen në një pikë, po konvergohen. Dikur ishin bashkë pastaj u ndanë, tani ato kanë filluar sërish të bashkohen dhe shumë gjëra të cilat janë thënë nëpër librat e mitologjisë, në folklor, në përralla në superticione shkenca ka filluar t'i vërtetojë. Dhe po dalin të vërteta, që nuk po i hedhin më në botën e përrallës, në botën e gënjeshtërs. Kjo po ndodh sot me fizikën kuantike, me psikologjinë, parapsikologjinë etj, pra kanë dalë në sipërfaqe disa shkenca që janë themeli dhe këto po vërtetojnë se shoqëria njerëzore po shkon drejt hapjes së syve. E vërteta kur jepej ishte patrimon i disa njerëzve, këta të fundit ishin dishepuj. Ndërsa sot njeriu po kalon në pozicionin jo më të mjeshtrit dhe të dishepujve, por vetë njeriu po bëhet mjeshtër dhe dishepull i vetes vet, domethënë po shkon drejt qendrës së vet. Njeriu po kërkon të vërtetat e qenies së tij dhe këtë ka arritur. Sot bota nuk është më mistike, por është një botë e vërtetë.

## **Treguat se keni një cikël punësh ku tre prej tyre i keni ekspozuar tashmë, me çfarë faze të krijimtarisë suaj përkon kjo pikturë e re?**

E them gjithmonë që jeta ime është shumë e thjeshtë. Shkoj çdo ditë në studio dhe pikturoj, sigurisht çdo lloj ndjesie që jeta të ofron, meditimi, trishtimi, gëzimi, dhimbja etj pasqyrohet në atë çfarë pikturoj. Nuk është se ndjek ndonjë plan shumë të madh. Po ka edhe piktura një lidhje, një temë por krijohen edhe të lira, në të cilat janë emocionet e momentit. Cikli i fundit ka të bëjë më shumë me dëshmitarin. Në këtë cikël shpesh herë kam vendosur në qendër të pikturës autoportretin tim. Pra, dëshmitar që sheh, si një shkak për të pikturuar motivet të cilat më shqetësojnë, që dua të merrem me to. Ky është momenti më i thjeshtë, sepse jetën e një artisti e konsideroj shumë më të thjeshtë nga pikëpamja horizontale, kur shkon në studio dhe pikturon gjithë ditën. Atje është momenti i frymëzimit tënd. Atje nëse ti ke çfarë të thuash do ta thuash se s'bën. Çfarë e shtyn çdo krijues të jetë brenda vetes, të kërkojë, të eksplorojë siç vjen triptiku juaj, një udhëtim drejt qendrës? Ne të gjithë bëjmë një udhëtim. Është po ai udhëtim që kanë bërë të gjithë heronjtë civilizues të mitologjisë, heronjtë antikë. Të gjithë kanë bërë udhëtimin e tyre mistik. Dhe udhëtimi mistik ka qenë një udhëtim drejt qenies. Herkuli me 12 heroizmat e vet ka bërë një udhëtim mistik, Prometeu për të vjedhur zjarrin për t'ju dhënë njerëzve ka bërë një udhëtim mistik, Odiseja për të shkuar mbas luftës së Trojës, dhe të kthehet prapë në Itakë është një udhëtim mistik po ashtu dhe Orfeu e të tjerë, pra të gjitha këto janë udhëtime mistike drejt qenies. Njeriu në pjesën e parë të tij tenton të dalë jashtë, dhe gjysma e udhëtimit të dytë është kthimi brenda vetes së tij. Dhe në fakt, ky është edhe më i vërteti. A mund quhet edhe një ikje nga realiteti, për të kërkuar të pamundurën udhëtimi juaj? Është e vështirë kjo, pse është e domosdoshme të ndodhë? Është shumë i vështirë ky udhëtim sepse njeriu e ka më të lehtë të shkojë nga brenda jashtë, sesa të hyjë nga jashtë brenda. Kur shkon jashtë gjërat duken, janë të prekshme më materiale, dhe hap pas hapi ti i ndjen. Ndërsa kur

hyn brenda ti mund të përplasësh me mendjemadhësinë tënde, me egoizmin tënd, ka shumë klone të cilat ty duan të të pengojnë dhe kthehen në monstra të fuqishme që nuk të lejojnë t'i depërtosh. Dhe t'i çash ato do të thotë që t'i të piqesh. Për të ardhur ky moment sigurisht që të duhet gjithë eksperiencia e asaj çfarë të ka ndodhur jashtë. Kjo është pastaj një moment që çdo njeri mban përgjegjësinë e vet. Unë mendoj se kjo nuk ka të bëjë thjesht me temën e të pasqyruarit udhëtim drejt qendrës, sepse ky udhëtim drejt vetes, qendrës, qenies kanë bërë pothuajse të gjithë piktorët. Po të shohësh edhe ata që realizojnë një natyrë të qetë, udhëtim drejt qenies bëjnë vetëm se shfaqet në një mënyrë tjetër. Nuk është se janë shenjat që e bëjnë të fuqishme, shenjat janë vetëm zgjedhja ime. Kthehemi tek “Onufri”. Këtë vit koncepti i kuratorit ishte pa temë, jo ndërkombëtar, ndërsa pas “Onufrit” të parë, vjen edhe ky edicion vetëm me artistë shqiptarë. A duhet të jetë sipas jush kjo ekspozitë një “Onufër” kombëtar, çfarë është bërë gabim deri tani? Ky nuk është “Onufri” i parë që bëhet vetëm me autor shqiptarë. Ekspozita e parë ishte krejtësisht me artistë shqiptarë. “Onufri” kur u nis u paraqit si një ekspozitë konkurs kombëtar, jo ndërkombëtar. Këtë e mbaj mend mirë sepse kam qenë në komisionin përzgjedhës. Duke mos pasur një rregullore të saktë, ose një statut, ose duke mos qenë të vëmendshëm për ta zbatuar këtë statut dalëngadalë u transformua, duke u bërë një konkurs ndërkombëtar. Nuk ka ndonjë gjë të keqe, por unë do të pretendoja që “Onufri”, meqë u nis si një konkurs kombëtar, duhet të vazhdonte si i tillë. Paralel me “Onufirin” mund të hapej një tjetër, që mund të ishte ndërkombëtar ku të ballafaqoheshin artistët shqiptarë, dhe ata të huaj (të vërtetë) që do të vinin. Për shembull është për t'u respektuar shumë ajo çfarë bën televizioni shqiptar me festivalin e këngës. Ky festival e ka ruajtur strukturën e vet, si konkurs kombëtar i këngës, dhe kushdo nesër një kritik nëse do të studiojë muzikën e lehtë shqiptare e ka të distiluar ngjarjen, mund t'i marrë festivalet t'i krahasojë dhe mund të ndërtojë një logjikë shumë të qartë. Dhe unë mendoj se kjo është detyrë shumë e madhe jo vetëm për artistët, por edhe për institucionet, kritikët që të paktën një konkurs, një herë në vit, ta

kenë kombëtar për të parë hartën e artit viziv shqiptar. Sepse ka shumë artistë të cilët punojnë edhe nëpër rrethe, për të cilët nuk mendoj se arti bëhet vetëm në Tiranë. Janë përdorur emra të artistëve të huaj ndërkohë që galeria jonë është e vogël, nuk ka shumë vend, dhe shumë nga artistët shqiptarë janë gjendur edhe të përjashtuar. Ju mendoni se Tirana është shndërruar në një ishull, që ndoshta pengon shkrimin e një historie të artit pamor në një territor më të gjerë? Në të gjitha vendet e mëdha, kryeqyteti gjithmonë ka lozur rol të rëndësishëm, kjo nuk diskutohet sepse është pika qendrore, aty janë institucionet, galeritë etj. Por një studiues i vëmendshëm, kritik, opinionist apo një personalitet i ministrisë duhet të jetë i vëmendshëm për të parë gjithë hartën sepse Shqipëria nuk mund të tkurret vetëm te Tirana. Unë njoh shumë artistë edhe jashtë Tiranës që kanë kualitet shumë të mirë, të cilët e pasurojnë hartën dhe në fund të fundit, neve na intereson të dimë të vërtetën dhe jo ta fshehim atë. Shpesh herë në konkurset ndërkombëtare janë përhapur shumë opinione jo të mira, që bie ndesh me këtë që po them tani, duke menduar se artistët shqiptarë kanë frikë të ballafaqohen me të huaj. Nuk është e vërtetë kjo. Këtu flitet që të njohësh gjithë hartën e artit që bëhet në Shqipëri. Për të gjitha fushat e kulturës jam i mendimit se duhet ruajtur një konkurs kombëtar. Nëse do të hapësh edhe një konkurs ndërkombëtar për ta bërë Tiranën edhe një pikë në hartën botërore, le të bëhet, është shumë e thjeshtë! Unë e kam propozuar edhe në vitet e para këtë gjë, në momentin që dëgjova se do të bëhet ndërkombëtar jam shprehur për të mos e prishur “Onufrin” dhe le të bëjnë në një sistem tjetër, paralel, ku të vijnë edhe të huajt. Duke parë prurjet e “Onufrit”, në cilin nivel e shikoni pikturën kombëtare, duke parë dhe prurjet e të rinjve, por dhe ata që njihen tashmë? E kam të vështirë të flas tani. Kësaj pyetje mund t’i përgjigjem fill pas konkursit dhe ne të jemi pak më të qartë për ato çfarë është sjellë në këtë ekspozitë. Tani nuk prononcohem dot për kualitetet që janë aty, sepse nuk do ishte e ndershme kjo. Por kur takova kuratorin dhe e pyeta se si ka ndërmend ta organizojë, doja të shihja dhe të dija se çfarë bëhet në Shqipëri, sepse ka vite që askush nuk ka bërë një ekspozitë të

përmasave të “Onufrit”, ku të thuhet e vërteta e asaj çfarë po ndodh nëpër studiot e artistëve. Unë e di, ka edhe shumë artistë të mirë që kanë mbetur jashtë, por mund të kenë mbetur për arsye të tyre ndoshta s’kanë pasur punë apo s’kanë pasur dëshirë të marrin pjesë etj. Por, qëllimi i Teferiçit m’u duk shumë i mirë; për të prezantuar një realitet të vërtetë pa gënjeshtër. U hap një debat në gazetën “standard” në lidhje me përkimin ideor të një vepre, konkurruese e “Onufrit”, i përdorur edhe si imazh i kësaj ekspozite, me një vepër të ekspozuar tek “Nëntori 12” - me këtë dua t’ju pyes si arrini ju ta njihni punën e njëri-tjetrit, kolegut, dhe a jeni vizitor i ekspozitave, sepse ndodh pastaj që të ndërtohen akuza, për plagja ideore pikërisht nga mosnjohja? Sigurisht që një artist apo intelektual mendoj se për ushqimin e tij shpirtëror duhet t’i ndjekë aktivitetet. Nuk po them të gjitha, por të shumtat po, goftë dhe për këtë që po thua, për të parë, për të njohur kolegun e tij, për të testuar veten e veten, për të parë edhe nivelin e artit në Shqipëri, korentet, diskutimet - pra është mirë që të jetë personazh, goftë edhe i heshtur. Nuk them se njerëzit këtu nuk e bëjnë, ata janë të interesuar. Shkojnë e vijnë nëpër studio apo ekspozita, por me kriter, me masë aq sa ua lejojnë miqësia, shoqëria. Por, këtu ka një varfëri të madhe në sallat e ekspozitave. Edhe galeritë private që tentuan të hapeshin në fillim tani janë në minimumin e tyre. E vetmja sallë e mirë e ekspozimit ka mbetur Galeria Kombëtare, Galeria e Akademisë së Arteve dhe ndonjë galeri tjetër private. Ka shumë pak hapësirë për ekspozimin e artistëve, në të kundërt mendoj se prurjet janë shumë të mëdha. Kjo krijon një lloj handikapi, ku nuk ekziston ai kordon që të lidhë gjithë prurjen artistike me manifestimin e tyre. Kështu që gjatë rrugës mund të ndodhin edhe incidente, lapsuse, por këto edhe sikur të jenë të qëllimshme apo të paqëllimshme duhet të vlejnjë për një diskutim. Nga pamja e jashtme mund të duket si një problem shumë i vogël, por e mira është që të gjendet si motiv për të hapur debat ku njerëzit të tregojnë çfarë është plagjiatura, se si edhe artistë të mëdhenj kanë luajtur me plagjiaturë. Të tilla gjëra janë edhe ndihmë të një publiku (sepse gazetën publiku e lexon për shembull), që ka dëshirë të marrë nga ky debat. Dhe vlera e



medias për mua në këtë rast është pickimi që i jep personit që ta detyrojë të “bërtasë”, të kërcejë dhe të shpalosë gjithë mendimin e tij intelektual, jo fyerjen. E ndoqa çështjen për të cilën flisni dhe besoj se ajo pikurë është një rastësi. Mosnjohja, pra, vjen e qëllimshme apo është një shoqëri e zënë shumë në hallet e veta? Unë nuk jam më i ri, që të kem kuriozitet që të bredh lart e poshtë, unë e di se çfarë ndodh në Shqipëri. Aty ky jam i interesuar edhe shkoj, por mund të qëllojë një moment që kur ke ethet e tua të krijimit, ti nuk do të shohësh asnjë lloj ekspozite. Kjo më ka ndodhur këto katër muaj. Shumë ekspozita për këtë arsye më kanë ikur pa parë, pasi kam krijuar një regjim shumë të fortë me veten time për të shkuar në studio për t’u marrë me çfarë krijoj. Kjo nuk do të thotë ta marrësh model. Ka njerëz që shkojnë e vijnë. Edhe në studion time e kam derën e hapur. Kam disa shokë e miq që i besoj, që janë të ndershëm në profesionin dhe karakterin e tyre, të cilëve u besoj për t’i shkëputur një mendim, por kjo vjen në momentin kur ti ke çfarë t’i tregosh. Por, është një lloj letargjie. Kjo është e vërtetë për realitetin tonë. Se nga vjen ky është një problem tjetër, qoftë nga problemet e jetës apo ekzistencës, mbijetesës apo pakënaqësitë!? Kjo është si puna e kurbave që njëherë ka pikun e vet më të mirë, më pas bie. Është ekspozita “Nëntori” tërësisht kombëtare. Ju nuk keni qenë asnjëherë pjesëmarrës, shpesh ajo është anatemuar duke u injoruar si vazhduese e traditës. Si e shikoni këtë ekspozitë dhe pse nuk është konkurrin do të merrnit pjesë nëse ju vjen ftesa? Një nga themeluesit e ekspozitës së “Nëntorit” është Besim Tula. Është miku im, një artist dhe intelektual për të cilin kam shumë respekt, shumë serioz në gjërat që bën, dhe vazhdimi i ekspozitës Nëntori është një rezistencë shumë e madhe. Ai nuk e braktisi, dhe gjithë kolegët tanë nuk e braktisën dhe kjo mua më duket një vlerë shumë e madhe. Ekspozita “Nëntori” është një pasuri për ambientin shqiptar. Unë nuk di të jetë anatemuar, nuk jam personazh i tavolinave të kafeneve ku fyhen e shahen artistët, ata që kontribuojnë me ndershmëri. E përsëris gjithnjë kam veçuar vlerën e madhe të kësaj rezistence. Sepse paralelisht, me ekspozitën, apo fillimisht kanë qenë shoqatat e artistëve të

pavarur mbarëshqiptare, ku isha pjesëmarrës, por këto dy shoqata janë shuar, nuk ekzistojnë por ekspozita “Nëntori” ekziston. Prandaj e përshëndes. Dikur Besimi më ka ftuar, por unë isha në një shoqatë dhe nuk mund të shkoja në një shoqatë tjetër. Sot në qoftë se Besimi më bën edhe një herë ftesën, sepse për refuzimin e parë më vjen pak zor, pavarësisht se kisha arsye, me gjithë dëshirë do merrja pjesë. Jam absolutisht mendje hapur, pa asnjë lloj paragjykimi. Për mua ata janë krijues të mirë, shumë nga ata janë profesorë të mi, por mbi të gjitha janë persona që kanë rezistuar dhe kanë punuar tërë jetën e tyre dhe janë marrë me artin. Ndërsa sa i përket vlerës dhe kualiteteve, ne të gjithë jemi në pozicion vëzhgimi. Natyrisht që ne të gjithë e dimë, por mund ta dimë edhe në mënyrë të deformuar. A është i vështirë tregu i artit këtu, a shiten pikturat, si e menaxhon punën tënde - si jeton një piktor? Sigurisht e kam mendjen që pikturën time ta bëj personazh në një shtëpi të dikujt që e blen. Por, jam mjaftuar me dy-tre koleksionistë. Kur mbaroj ciklet e mia, pasi arrij të krijoj një sasi punësh, i thërras në studion time. Kohët e fundit është një koleksionist shqiptar, me t’u kthyer nga Amerika kërkoi të vinte në studion time dhe bleu tri punë. Këto ditë jam në pritje të dy personazheve të tjera që do vijnë në studio, ata nuk i diskutoj, sepse sa herë që vijnë në studio, më marrin dy-tri punë. Nuk më pëlqen të shes shumë. Më pëlqen ta ruaj për ca kohë pikturën që bëj sot. Do dhe ajo staxhionimin si puna e verës për ta testuar, për ta degustuar unë i pari - nëse ja vlen apo jo. Nuk jam nga ata që më mjafton vetëm të shitet. Do më pëlqente shumë, që edhe vepra ime më e mirë t’i shkojë tjetrit. Mungesën e tregut nuk e kam ndjerë. Natyrisht do doja të ishte një treg akoma edhe më i organizuar. Mund të hapeshin ankande, mund të bëheshin edhe më shumë ekspozita, por mos harrojmë se jemi në periudhë krize, është gjithë bota kështu, kjo e bën këtë një periudhë të vështirë. Pasi përpara luksit është mbijetesa e njerëzve. Por mua më bën shumë përshtypje që në Shqipëri njerëzit blejnë piktura edhe me çmime shumë të mëdha, e blejnë me dëshirën më të madhe, dhe kanë kualitet. Është interesante edhe fakti se të gjithë njerëzit që më hyjnë në studio më thonë se nuk marrin vesh nga piktura, por

pikturën më të mirë zgjedhin! Kjo është një tregues për ta. A mendoni se në Shqipëri është akoma e pazbuluar çështja se si funksionojnë koleksionistët, si arrijnë ta nuhasin pikturën që do t'i rezistojë kohës? A kemi hyrë ne në perceptimin e kulturës apo mendësisë se koleksionisti e përcakton fatin e piktorit? Së pari, për piktorët që kanë një emër, kualitet, të cilët kanë vendosur me kohë ekzistencën e tyre, kam përshtypjen se duhet të ndërhyjë shteti. E para është Galeria Kombëtare që duhet të marrë prurjet më të mira për t'i futur në arkivin e saj, por unë mendoj se edhe institucionet si Kryeministria, Presidenca, ministritë duhet të kenë vepra të artistëve shqiptarë. Këto institucione pothuaj janë inekzistente - qoftë dhe kur presin delegacionet apo në një mbledhje shumë të rëndësishme është bukur që në muret e tyre të jenë veprat e artistëve shqiptarë, sepse kjo tregon dinjitet. Pjesa e koleksionistëve shqiptarë është pjesë e dëshirës së tyre dhe unë kam një respekt të madh. Nuk është se këto janë të organizuar, por janë thjesht njerëz të cilët kanë një dëshirë të madhe për artin, e konsiderojnë që në shtëpinë e tyre të fusin një pasuri të patundshme dhe në njohjet që ata kanë bredhin nëpër studiot e artistëve dhe ndalojnë atje ku kanë dëshirë për të ndaluar. Por, sot për sot ky organizim i koleksionistëve është sporadike. Është një grup të cilët komunikojmë me njëri-tjetrit. Cila është vlera me e madhe financiare, shumica me të cilën është blerë piktura juaj? Nuk dua të shkoj deri këtu, sepse mund të jenë edhe gjëra të rastësishme. Nëse flitet për një sistem, për një kuotë - nëse e arrin këtë, ti nuk mund ta realizosh më aty për aty. Është pak si një goditje qorre çfarë po ndodh sot me vlerën financiare të pikturës, si fati i diletantit.